



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e Analizave Politike

Analiza Politike Nr. 15

# **Decentralizimi në Kosovë I: Zgjedhjet komunale dhe pjesëmarrja e serbëve**

Prishtinë, dhjetor 2009

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

Ky projekt është përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Kosovë.

Përgatitur nga: Ilir Deda

Copyright © 2009 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
Rexhep Mala, 5A, Kati II  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefon dhe Fax: +381 38 227 778  
[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## I. Hyrje

Kosova ka përfunduar një nga fazat më sfiduese të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin (PGJS), të hartuar nga presidenti Ahtisari, gjegjësisht atë të krijimit të komunave të reja dhe të procesit të decentralizimit, përmes organizimit të zgjedhjeve komunale më datën 15 nëntor 2009. Këto zgjedhje kanë qenë thelbësore nga dy aspekte – ato kanë qenë të parat që janë organizuar pas shpalljes së pavarësisë, përderisa pjesëmarrja e serbëve ka qenë tepër e rëndësishme në mënyrë që të legjitimizohej krijimi i komunave të reja. Kosova ka korrur sukses në të dy këto aspekte, pra, ka treguar aftësi për organizimin e zgjedhjeve në mënyrë vetanake, ndërsa pjesëmarrja e serbëve ishte një goditje për Beogradin dhe për idenë e ndarjes së Kosovës. Serbët kanë fituar në katër komuna, i kanë bojkotuar zgjedhjet në tri komunat e veriut të Kosovës, kanë humbur në një komunë, ndërsa zgjedhjet për komunën e re të Mitrovicës së Veriut dhe për Parteshin në lindje të Kosovës duhet të mbahen në maj të vitit 2010. Dalja e përgjithshme e serbëve në zgjedhje ka qenë dhjetë herë më e madhe në zgjedhjet e organizuara në Kosovën e pavarur sesa në ato të nëntorit 2007, derisa Kosova ende administrohej nga UNMIK-u.

Klima e përgjithshme e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike gjithashtu ka ndikuar në qëndrimet e serbëve nga jugu i lumit Ibër kundruall Beogradit. Të vendosur për të qëndruar në shtëpitë e tyre në jug të Mitrovicës, serbët e Kosovës kanë kundërshtuar Beogradin dhe dolën në zgjedhje në numra domethënës në vendbanimet më të mëdha në jug të lumit Ibër, siç janë Graçanica dhe Shtërpca, vendbanimet qendrore dhe jugore më të mëdha pas Mitrovicës së Veriut që kontrollohet nga serbët. Dalja e serbëve nga këto vendbanime në zgjedhje ka qenë më e madhe se sa në zgjedhjet paralele komunale të organizuara nga Beogradi në maj 2008 dhe në gusht 2009.

Përmes këtij veprimi, ata i dërgojnë porosi vendimtare Beogradit, Prishtinës dhe bashkësisë ndërkombëtare – atë se kontrolli i komunave të reja nga ta është opsioni i vetëm i realizueshëm, përmes të cilit ata do të kenë perspektivë për një jetë dhe zhvillim të qëndrueshëm, pavarësisht prej statusit të Kosovës. Pjesëmarrja e serbëve ka diskredituar në mënyrë të efektshme idenë e ndarjes së Kosovës, dhe ka dhënë një shtytje të re në ndërtimin e një shteti shumetnik. Tani është koha që qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare të ndër marrin hapa për të siguruar besimin e serbëve tek institucionet e Kosovës.

Për dallim prej bashkëkombësve të tyre në jug, serbët në veri plotësisht kanë bojkotuar zgjedhjet komunale. Ky bojkot erdh si rezultat i tre faktorëve: ngacmimeve dhe kërcënimeve nga forcat paralele serbe të sigurisë, nga mobilizimi i forcave politike radikale serbe kundër zgjedhjeve dhe nga mospjesëmarrja në zgjedhje e një entiteti politik të besueshëm serb. Një parti e serbëve të Kosovës në Zveçan - Bashkimi për të Ardhmen Evropiane - e cila është certifikuar për zgjedhje komunale, u tërhoq pak ditë para 15 nëntorit, pasi që u hodhën granata dore në shtëpinë e udhëheqësit të saj Bozhidar Stojkoviç.

Të gjithë këta faktorë janë mbikëqyrur dhe përkrahur nga fraksione të qeverisë së Serbisë, e cila vazhdojë t'u dërgojë serbëve të Kosovës sinjale të përziera. Kryetari Tadiq dhe kryeministri Cvetkoviç kanë qëndruar jashtë debatit për zgjedhjet në Kosovë, pas deklaratave të tyre në qershor dhe korrik se nuk kishte kushte për serbët që të marrin pjesë në procesion zgjedhor. Serbët kanë lënë këtë çështje në duart e Ministrisë për Kosovë e Metohi, e cila kishte porosi jokohërente dhe jokonsekuente. Thënë në përgjithësi, udhëheqësia në Beograd ka pritur një dalje të vogël të serbëve në zgjedhjet komunale, dhe ka qenë e shokuar pas marrjes së informatës për dalje të madhe të serbëve

të Graçanicës në zgjedhje. Sekretari shtetëror i Ministrisë për Kosovë e Metohi pranoi se dalja e serbëve në zgjedhje ka tundur autoritetin e Beogradit, ndërsa ministri Bogdanoviç ka ftuar për unitet, dhe deklaroi se nuk do të ketë ndëshkime për serbët që kanë marrë pjesë në zgjedhje.

Prania ndërkombëtare në Kosovë ka luajtur një rol shumë pozitiv në inkurajimin e serbëve që të marrin pjesë në zgjedhje pasi të gjitha keqkuptimet mes anëtarëve të shteteve të Kuintit u zgjodhën më 15 shtator 2009. Veçanërisht aktiv ka qenë udhëheqësi i ICO-s dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe ai i Mbretërisë së Bashkuar, të cilët vizituan vendbanimet serbe në komunat e reja, duke avokuar dhe shpjeguar rëndësinë e decentralizimit dhe të pjesëmarrjes në zgjedhje.

Përmes kësaj analize, shtjellohet procesi i krijimit të komunave të reja nga korriku i vitit 2009, dhe ngjarjet që çuan në daljen e serbëve në zgjedhje, gjë e cila befaso i Beogradin, ashtu edhe praninë ndërkombëtare në Kosovë. Pas dy dekadave, serbët e Kosovës u janë kthyer forcave të tyre të moderuara politike, që parqet një hap të rëndësishëm përpara. Serbët kanë bërë hapin e tyre drejt ndërtimit të mirëbesimit, ndërsa tani është koha që qeveria e Kosovës dhe prania ndërkombëtare të veprojnë me vullnet të mirë.

## II. Procesi

### a) Prishtina

Shumica e vendimeve për zgjedhjet e nëntorit 2009 janë marrë në momentin e fundit, duke rrezikuar kështu suksesin e tërë procesit. Mungesa e një agjende të përbashkët të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë ka krijuar një huti parazgjedhore, e cila ka vonuar shumë vendime të autoriteteve të Kosovës dhe të Zyrës Ndërkombëtare Civile (ICO) dhe pothuajse çojë procesin e decentralizimit në buzë të dështimit. Kjo mungesë e konsensusit ka pasur të bëjë me mendime kundërthënëse nëse do të duhej të krijoheshin komunat e reja dhe, rrjedhimisht, nëse do të duhej të mbaheshin zgjedhjet në 38 komuna, siç parashihej me ligj, apo në 33 sosh. Ky debat ka qenë absurd, duke marrë parasysh gatishmërinë e serbëve që të marrin pjesë në zgjedhjet lokale në komunat e tyre.<sup>1</sup>

Pavarësisht nga kjo huti, Komisioni Qendror për Zgjedhje (KQZ) filli përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve lokale në 38 komuna. KQZ-ja vendosi t'i përmbahet ligjit dhe filloi së përgatituri të listave të votuesve për të gjitha komunat, pavarësisht nga mosdeklarimi i ICO-së, shteteve të Kuintit dhe i qeverisë së Kosovës. KQZ-ja paralajmëroi ICO-në se pasi të jenë përfunduar listat komunale të votuesve, nuk do të ketë mundësi të kthimit në numër më të vogël të komunave, dhe se një vendim tjetër do të rrezikonte përgatitjet teknike për mbajtjen e zgjedhjeve të nëntorit.<sup>2</sup> KQZ-ja u ankua publikisht se nuk mund të vazhdojë me shumë përgatitje zgjedhore pa e ditur numrin e saktë të këtyre qarqeve.<sup>3</sup>

ICO-ja emëroi anëtarët e Ekipeve të para Përgatitore Komunale (EPK), që janë të nevojshme për caktimin e themeleve të komunave të reja në bazë të Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës<sup>4</sup> - për Killokot kjo u bë më 15 korrik 2009. Ekipi i

<sup>1</sup> Për informata rreth historikut, luteni të shihni raportin e KIPRED-it "Kosova në udhëkryq: Decentralizimi dhe krijimi i komunave të reja", Korrik 2009, <http://www.kipred.net>

<sup>2</sup> KIPRED, intervista me zyrarët e KQZ-së, korrik/gusht 2009.

<sup>3</sup> Deklarata e kryesuesit të KQZ-së, dhënë KTV-së, shtator 2009.

<sup>4</sup> Shih më lartë në 1.

dytë për komunën e Graçanicës është emëruar më 13 gusht, disa ditë para se Serbia të organizonte zgjedhjet paralele, ndërsa EPK-ja i tretë për komunën e Ranillugut është themeluar më 28 gusht dhe ekipi i katërt për Novobërdën, më 29 tetor 2009. Megjithatë, për shkak të mungesës së konsensusit brenda anëtarëve të Kuintit, ICO-ja nuk mundi të vazhdojë me themelimin e EPK-ve për komunën e Parteshit dhe të Mitrovicës, edhe pse ata kishin botuar shpalljet për këto pozita dhe kishin punësuar stafin për EPK-në e Parteshit. ICO-ja deklaroi se zgjedhjet lokale në Mitrovicën e Veriut dhe në Partesh do të mbahen jo më vonë se më 16 maj 2010.<sup>5</sup> EPK për Partesh është themeluar në dhjetor të vitit 2009, ndërsa rasti i ri i punësimit për EPK-në e Mitrovicës së Veriut ka filluar më 23 dhjetor.<sup>6</sup>

Data 15 shtator 2009 është dhënë si datë e fundit për certifikimin e të gjitha entiteteve politike që dëshirojnë të garojnë në zgjedhje komunale. Kjo i la entitetet politike serbe dhe disa udhëheqës me ndikim lokalë serbë në një gjendje as në tokë e as në qiell, pasi që nuk ishin të sigurt a të aplikojnë apo jo, duke mos ditur se a do të garojnë për komunat e reja.<sup>7</sup> Njëkohësisht, 21 entitete politike të serbëve nga Kosova aplikuan për certifikim, me një mundësi të tërheqjes nga gara zgjedhore nëse nuk do të themelohen komunat e reja. Më 15 shtator, shtetet e Kuintit ia dhanë dritën e gjelbër ICO-së për të shpallur se tri komunat e reja – Graçanica, Klllokoti dhe Ranillugu – ishin të gatshme për zgjedhje.

Vendimi u shpall në mbrëmje të datës 15 shtator, vetëm pak orë para afatit të fundit për certifikim nga KQZ-ja. Disa udhëheqës dhe entitete politike serbe kërkuan që afati i fundit për certifikim të zgjatet në mënyrë që të përgatiteshin për certifikim, por kjo kërkesë u refuzua nga KQZ-ja dhe nga të gjitha palët e tjera me interes. Rrjedhimisht, shumë serbë lokalë, udhëheqësit e parapëlqyer të të cilëve nuk mundën të certifikoheshin apo të cilët refuzuan të aplikojnë për certifikim në momentin e fundit, nuk morën pjesë në zgjedhje. Përveç kësaj, roli i qeverisë së Beogradit në ndalimin e serbëve që të marrin pjesë në zgjedhje ka vazhduar, mu sikurse ishte rasti edhe në zgjedhjet paraprake të organizuara në Kosovë.

Pas shpalljes së vendimit, prania ndërkombëtare në Kosovë dhe qeveria e Serbisë filluan një vistër aktivitete. Udhëheqësi i ICO-së dhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara dhe ai i Britanisë së Madhe filluan t'i vizitojnë vendbanimet serbe dhe të mbajnë takime me udhëheqësit politikë dhe komunitarë serbë për t'ua shpjeguar atyre përparësitë e komunave të reja dhe nevojën për pjesëmarrje në zgjedhje. Rrezikimi i pranisë ndërkombëtare ka qenë i madh sepse ajo frikohej se dalja e serbëve në zgjedhje do të jetë e vogël, duke marrë parasysh keqmenaxhimin e procesit nga ana e vet tyre.

## b) Beogradi

Udhëheqësia më e lartë e Serbisë mbajti një distancë lidhur me zgjedhjet lokale në Kosovë. Qeveria në Beograd e la Ministrinë e saj për Kosovë e Metohi që të merret me këtë çështje, e cila nuk kishte një pozitë të njëzuar, dhe ishte e ndarë mes ministrit dhe sekretarit të shtetit.

Përderisa deklaratat publike të ministrit Goran Bogdanoviq ishin kryesisht pajtuese, sekretari i shtetit Oliver Ivanoviq mbajti një vijë të fortë. Bogdanoviqi vazhdimisht përsëriste se përderisa Serbia nuk mund të përkrahë pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës

<sup>5</sup> KIPRED, intervistat me zyrtarët e qeverisë së Kosovës dhe të ICO-së, nëntor/dhjetor 2009

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> KIPRED, intervistë me udhëheqësin lokal serb, Graçanicë, shtator 2009.

në zgjedhje, kjo është një e drejtë demokratike e serbëve dhe nuk do të kishte pasoja për ata që marrin pjesë. Nga ana tjetër, Ivanoviçi, ka përdorur një ton kërcënues, duke thanë se do të ketë ballafaqime ndërmjet serbëve dhe se ata që marrin pjesë në zgjedhje do të ballafaqohen me pasoja dhe do ta humbin përkrahjen e Beogradit<sup>8</sup>. Ivanoviçi në mënyrë publike ka kërcënuar, duke thanë se “do të ketë ndëshkime për serbët që do të marrin pjesë” dhe tha se do të ketë konflikt mes serbëve nëse krijohen komunat e reja<sup>9</sup>. Prapa këtyre deklaratave jokonsekuente qëndronte lufta për pushtet mes Bogdanoviçit dhe Ivanoviçit, dhe përpjekjet e tyre për t’i përmirësuar pozitat e tyre në Beograd.<sup>10</sup>

Kisha Ortodokse Serbe (KOS) është përfshirë në çështje, duke nxjerrë deklaratë nga Sinodi i saj i shenjtë, përmes së cilës serbët ftohen që të mos marrin pjesë në zgjedhjet e organizuara nga institucionet e paligjshme<sup>11</sup>, duke shkaktuar druajtje të shumë priftërinjve të KOS-it në Kosovë, të cilët në mënyrë të heshtur e kundërshtuan këtë thirrje dhe të cilët e kundërshtojnë politikën e Beogradit për serbët e Kosovës<sup>12</sup>. Në realitetet, Sinodi i shenjtë kurrë nuk është takuar për ta diskutuar çështjen, por deklarata është shkruar vetëm nga mitropoliti Amfilohije.<sup>13</sup> Qëndrimi zyrtar i KOS-it është elaboruar nga peshkopi Artemije, i cili tha se çdo serb që merr pjesë në zgjedhje do të njihet dhe legjitimizonte pavarësinë e Kosovës.<sup>14</sup> Artemije më pas deklaroi se ai nuk e kuptonte politikën e Beogradit të dërgimit të porosive jokonsekuente rreth pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhje.<sup>15</sup> Në përgjithësi, është hera e parë që Beogradi nuk ka përdorur të gjitha instrumentet e tij në terren për t’i kundërshtuar zgjedhjet.

### c) Dinamikat brenda serbëve të Kosovës

Procesi zgjedhor e polarizoi komunitetin serb në Kosovë. Në kuadër të spektrit politik ishin dy grupe, të cilat ishin të qarta rreth pozicioneve të tyre për dhe kundër pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhje.

Jokonsekuenca e Beogradit ishte në fokus të forcave radikale serbe të Kosovës, të udhëhequra nga Marko Jakshiq dhe Milan Ivanoviçi në Kosovën e veriut dhe të strukturave paralele në jug të Ibrit. Përmes kuvendit të tyre të komunave të Kosovës e metohisë, Jakshiqi dhe Ivanoviçi janë përfshirë drejtpërsëdrejti në këtë tematikë, duke i ftuar serbët që të bojkotojnë zgjedhjet.<sup>16</sup> Ata gjithashtu kanë shfrytëzuar Këshillin Kombëtar Serb (KKS) për Kosovën e veriut si një instrument tjetër kundër zgjedhjeve<sup>17</sup>, dhe kanë kërkuar nga qeveria e Beogradit që të shpall “zgjedhjet krahinore” në Kosovë. Megjithatë, jo të gjithë serbët radikalë i kundërshtuan zgjedhjet. Anëtarët e strukturave paralele dhe partia radikale Serbe (PRS) në jug të lumit Ibër, posaçërisht në Graçanicë, krijuan lista qytetare apo parti të bashkuara politike serbe që janë certifikuar për zgjedhje.

<sup>8</sup> Ivanovic: Ucesnici kosovskih izbora rizikuju svoje radon mesto, <http://www.blic.rs/politika.php?id=118969>

<sup>9</sup> Veliki i veci Srbi, [http://www.b92.net/info/emisije/kaziprst.php?yyyy=2009&mm=11&nav\\_id=393114](http://www.b92.net/info/emisije/kaziprst.php?yyyy=2009&mm=11&nav_id=393114)

<sup>10</sup> KIPRED, intervistat me politikanët serbë të Kosovës, nëntor/dhjetor 2009.

<sup>11</sup> Faqja e internetit e KOS-it:

[http://www.spc.rs/eng/communique\\_holy\\_synod\\_bishops\\_soc\\_october\\_15th\\_2009](http://www.spc.rs/eng/communique_holy_synod_bishops_soc_october_15th_2009)

<sup>12</sup> KIPRED, intervistat me KOS, tetor/nëntor, 2009.

<sup>13</sup> KIPRED, intervistat me KOS, tetor 2009.

<sup>14</sup> Artemije: Serbët nuk duhet të marrin pjesë në zgjedhje.

[http://www.rtv.rs/sr/vesti/politika/kosovo\\_i\\_metohija/2009\\_10\\_15/vest\\_157000.jsp](http://www.rtv.rs/sr/vesti/politika/kosovo_i_metohija/2009_10_15/vest_157000.jsp)

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Sadri Ferati: Srbi treba da izadju na izbore ako zele legitimet za nove opstine

[http://www.danas.rs/vesti/politika/srbi\\_treba\\_da\\_izadju\\_na\\_izbore\\_ako\\_zele\\_legitimet\\_za\\_nove\\_opsti\\_ne.56.html?news\\_id=165080](http://www.danas.rs/vesti/politika/srbi_treba_da_izadju_na_izbore_ako_zele_legitimet_za_nove_opsti_ne.56.html?news_id=165080) – qasur më 5 dhjetor 2009.

<sup>17</sup> Milan Ivanovic: Srbi da ne glasaju na lokalnim izborima, <http://www.tanjug.rs>, arkivat, 30 tetor.

Ngacmimet nga strukturat paralele në Novobërdë dhe në Shtërpçë kanë qenë të mëdha, duke i kërcënuar serbët që do t'i humbin ndihmat financiare nga Beogradi ose që do të arrestoheshin.<sup>18</sup> Por, në Kosovën qendrore strukturat paralele nuk kanë qenë të bashkuara – Rada Trajković, drejtoreshë e shtëpisë së shëndetit në Graçanicë dhe njëra nga udhëheqëset e Këshillit Kombëtar Serb (KKS), dhe Rangjell Nojkić, drejtor i postës paralele dhe udhëheqës i degës së Kosovës të Lëvizjes së Ripërtërjes Serbe (LRS) të Vuk Draskovićit kanë kundërshtuar hapur Beogradin. Ata kanë marrë pjesë në mënyrë aktive, kanë ftuar dhe kanë avokuar për pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje. Këshilli Kombëtar Serb (KKS) që gjendet në Graçanicë, po ashtu u nda në dy pjesë. Derisa Rada Trajković lobonte dhe i ftonte serbët që të pranojnë procesin zgjedhor, Dragan Velić me një grup të pasuesve të tij refuzonte një gjë të tillë, ku së bashku me një numër të caktuar të delegatëve hartoi deklaratën e bojkotit. Pas 15 nëntorit, KKS-ja përjashtoi Rada Trajkovićin nga radhët e saj së bashku me pasuesit e saj Goran Marinković dhe Boban Petrović<sup>19</sup>. Trajković deklaroi se përjashtimi i saj kanë qenë i paligjshëm – deklaratë kjo e përkrahur nga KKS-të lokale në Kosovën lindore dhe jugore.

Nga kjo huti gjithashtu ka përfituar edhe një pjesë e qeverisë në Beograd. Serbia nuk mund të mbajë ngarkesën financiare të strukturave paralele në mbarë Kosovën për shkak të krizës ekonomike. Rrjedhimisht, ajo mban rrjedhën e parave të gatshme kryesisht në veriun e Kosovës së bashku me strategjinë e saj të ndarjes së Kosovës përgjatë lumit Ibër.

Një aktor shumë i rëndësishëm lokal doli të jetë Partia e Pavarur Liberale (PPL) e serbëve të Kosovës, e cila merr pjesë në qeverinë e Kosovës. Baza e partisë PPL gjendet në rajonin e Graçanicës. Në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të vitit 2007, PPL ka marrë 701 vota. Kjo parti ka qëndrim bashkëpunues me institucionet e Kosovës dhe është pjesë e tyre. Paralelisht me aktivitetet e “institucioneve paralele”, PPL shfrytëzoi pozitën e saj në qeverinë e Kosovës, kryesisht Ministrinë për Komunitete dhe Kthime (MKK) për të rritur pushtetin e saj. PPL-ja, përmes mekanizmave të qeverisë së Kosovës dhe përmes bashkëpunimit me USAID-në ka përfunduar rindërtimin e shkollës filllore “Knez Lazar” në Dobrotin, të çerdhes në Preoc, të objektit shëndetësor në Suhodoll, si dhe ka rregulluar varrezat në fshatin Dobrotin. Përmes MKK-së PPL-ja ka drejtuar mbi 800.000 € për zhvillimin e komunitetit, duke ndërtuar urën në Dobrotin, duke ndërtuar urën dhe rregulluar shtratin e lumit Vorbovac, dhe duke rindërtuar rrugën mes fshatrave Preoc dhe Llaplesellë. Gjithashtu ka ndërtuar një fushë të mbuluar të sportit në Graçanicë dhe një fushë të sportit në Dobrotin. Po kështu, ka ndërtuar 60 banesa në Llaplesellë, 20 në Graçanicë dhe 14 në Dobrotin për të kthyerit serbë të Kosovës.

Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK), në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZK) ka pasur ndikim domethënës në ndërtimin e mirëbesimit në mesin e serbëve lokalë. Ajo ka udhëhequr komunikimet me strukturat paralele serbe dhe ka zbatuar projekte infrastrukturore në Kosovën qendrore, në Ranillug dhe në Novobërdë. Përfshirja e ZÇK-së në Ranillug ka qenë ndihmuese në përpjekjet për t'i bindur serbët e atij vendi për të marrë pjesë në zgjedhje. Atje ka filluar me ndërtimin sistemit të ujësjellësit dhe me ndërtimin e rrugëve. Po kështu, ka filluar ndërtimin e 30 banesave në Ranillug<sup>20</sup>. Gjithashtu kjo Zyra ka ndërmarrë nismën për ndërtimin e spitalit në Graçanicë dhe të disa banesave në Shtërpçë.

<sup>18</sup> KIPRED, intervistat në Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë: tetor/nëntor 2009.

<sup>19</sup> Rada Trajković isklucena iz SNV, Vecernje Novosti, 1 dhjetor 2009.

[http://www.novosti.rs/code/navigate.php?Id=1&status=jedna&vest=164225&title\\_add=Rada%20Trajkovi%20i%20isklju%20iz%20SNV&keyword\\_add=rada%20trajkovic%20i%20snv](http://www.novosti.rs/code/navigate.php?Id=1&status=jedna&vest=164225&title_add=Rada%20Trajkovi%20i%20isklju%20iz%20SNV&keyword_add=rada%20trajkovic%20i%20snv)

<sup>20</sup> KIPRED, intervista me Srgjan Sentiq, drejtor i ZÇK, tetor/nëntor 2009.

#### d) Zgjedhjet paralele

Në mesin e hutisë lidhur me krijimin e komunave të reja, Beogradi shkoi tutje duke organizuar zgjedhjet paralele më 16 gusht 2009 për “komunën e Prishtinës” në Graçanicë dhe për “komunën e Pejës” në Gorazhdec. Në prill, qeveria e Serbisë kishte shpërbërë këto dy komuna paralele. Në këto zgjedhje u shënuan 26.090 votues të regjistruar,<sup>21</sup> nga të cilët 10,397 në vendbanimet e serbëve të Kosovës në komunën e Prishtinës dhe 15.693 persona të zhvendosur në Serbi.

Në Kosovë dolën në këto votime 3.545 votues apo 35% të serbëve të Kosovës, dhe arritën rezultatet vijuese: Partia Progresiste Serbe (SNS) - 1.201 vota, SPS-PUPS-JS-“Vidovdan” - 700 vota, DS - 588 vota, SRS - 528 vota, grupi qytetar “Opstanak” - 367 vota dhe DSS – 161 vota<sup>22</sup>. Këto zgjedhje shënuan përfundimin e mbizotërimit të Partisë Radikale Serbe (SRS) në mesin e serbëve të Kosovës<sup>23</sup>. SNS, DS dhe DSS formuan koalicionin për të udhëhequr komunën paralele. Kjo lëvizje befasoi shumëkënd, pasi që një koalicion i tillë ka qenë i papritur dhe është i pari i tillë në mesin të tri forcave politike. Më 29 tetor, kuvendi paralel i komunës zgjodhi anëtarin e SNS-së për kryetar të ri të “komunës së Prishtinës” dhe i ftoi serbët që t’i bojkotojnë zgjedhjet e nëntorit.<sup>24</sup>

Pjesëmarrja e ulët e serbëve të Kosovës ka shokuar Beogradin. Qëllimi i tyre ka qenë që edhe më shumë ta diskreditojnë procesin e krijimit të komunave të reja dhe të tregojnë se vetëm Serbia mund të flet për serbët e Kosovës. Mirëpo, realiteti në terren ka qenë krejtësisht tjetër. Një numër i udhëheqësve të Serbëve të Kosovës në Graçanicë ka punuar drejt dekurajimit për pjesëmarrje në zgjedhjet e Serbisë<sup>25</sup>, duke përgatitur kështu terrenin për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e Kosovës në nëntor.

Më 29 nëntor, Serbia organizoi zgjedhjet paralele në komunën më veriore të Kosovës – Leposaviqin. Nga gjithsej 11.888 votues të regjistruar, 8.224 apo 67% kanë hedhur votat e tyre. Kjo është hera e parë që DS-ja ka fituar në një komunë në Kosovë. DS-ja mori 2.745 vota, SNS-ja 1.540 vota, DSS-ja 1.038 vota, SPS-PUPS-JS-PV 916 vota, NS-ja 485 vota dhe SRS-ja 448 vota<sup>26</sup>. Kjo është paraqitur si një fitore e madhe për Serbinë dhe si një reagim i drejtpërdrejtë ndaj zgjedhjeve komunale të organizuara nga Kosova dy javë më herët. Gjithashtu, ky ishte një sukses i madh për DS-në, si dhe për ministrin

---

<sup>21</sup> Komisioni republikan zgjedhor i Serbisë.

[http://www.rik.parlament.sr.gov.yu/cirilica/sednice\\_frames.htm](http://www.rik.parlament.sr.gov.yu/cirilica/sednice_frames.htm)

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Komisioni Republikan Zgjedhor (KRZ) i Serbisë, pas numërimit të votave të personave të zhvendosur, ka publikuar rezultatet vijuese: SNS 1,677 vota (32,7%), SPS-PUPS-JS-“Vidovdan” 1,016 vota (19,8%), SRS 777 vota (15,15%), DS 756 vota (14,7%), grupi i qytetarëve “Opstanak” 482 vota (9,4%) dhe DSS 322 vota (6,28%)<sup>23</sup>. Dalja e përgjithshme në zgjedhje sipas KRZ-së ishte 5,129 votues ose 19,66% e numrit të përgjithshëm të elektoratit.

<sup>24</sup> Odbornici pozvali na bojkot kosovskih izbora 15. novembra

<http://www.tanjug.rs/Dogadjaji/2009/VladaSrbije/oktobar/29.htm> - qasur me 15 dhjetor 2009.

<sup>25</sup> KIPRED, intervista me serbët e Kosovës që udhëheqin institucionet paralele në Graçanicë, 14/17 gusht 2009.

<sup>26</sup> Komisioni republikan zgjedhor i Serbisë:

[http://www.rik.parlament.sr.gov.yu/cirilica/sednice\\_frames.htm](http://www.rik.parlament.sr.gov.yu/cirilica/sednice_frames.htm)



Bogdanoviq, i cili filloi t'i përdorë rezultatet e zgjedhjeve për të fuqizuar pozitën e tij si brenda DS-së, ashtu edhe në qeverinë e Beogradit.<sup>27</sup>

Në bazë të rezultateve të zgjedhjeve, është evidente një rënie e madhe e ndikimit të SRS-së dhe DSS-së. Është hera e parë në dy dekada që serbët e Kosovës janë duke drejtuar përkrahjen e tyre drejt forcave më të moderuara politike. Duke qenë përkrahësit e fundit dhe më besnikët të Slobodan Millosheviqit dhe të Vojislav Sheshelit që nga vitet 1990-ta, duket se në mesin e serbëve të Kosovës epoka e radikalizmit ka përfunduar.

### III. Pjesëmarrja në zgjedhje

Të gjitha palët me interes ishin të shqetësuara lidhur me daljen e serbëve në zgjedhjet e 15 nëntorit. Shumica e tyre kishin pritje minimale, duke shpresuar se në skenarin më të mirë serbët do të fitonin në Graçanicë dhe në Kllokot. Megjithatë, në mëngjesin e hershëm filloi të përhapet lajmi për daljen e serbëve në zgjedhje. Rrjedhimisht, u shënuan numra të lartë të serbëve që po votonin në Graçanicë dhe në fshatrat përreth. Më vonë gjatë pasdites serbët dolën të votojnë edhe në Ranillug, Kllokot, Novobërdë dhe në Shtërpcë. Numrat ishin vazhdimisht të ulët në Novobërdë, ku strukturat paralele vazhdonin t'i kërcënonin serbët vendorë se do të humbnin ndihmat nëse dalin të votojnë. Madje as lajmi nga Graçanica nuk mund t'i mobilizonte serbët në Novobërdë. Punëdhënësit në strukturat paralele dolën në mbrëmjen e hershme në numra të konsiderueshëm në Graçanicë dhe në Ranillug.<sup>28</sup>

Njëzet e dy entitetet politike serbe që u certifikuan për zgjedhje kanë garuar në 17 komuna të Kosovës<sup>29</sup>, duke përfshirë edhe tri komunat në Kosovën veriore – Zveçanin, Leposaviqin dhe Zubin Potokun. Ndërsa në veri nuk u shënuan ndonjë dalje e serbëve, por ishte më e larta në shumicën e vendeve në jug të lumit Ibër. Në të dyja raundet, më 15 nëntor dhe më 13 dhjetor, mbi 10.000 serbë hodhën votën e tyre, krahasuar me përafërsisht 1.300 që kishin votuar në vitin 2007. Elektorati i përgjithshëm serb në Kosovë vlerësohet të jetë rreth 80.000.<sup>30</sup>

SLS-ja luajti rolin kyç për mobilizimin e serbëve në Graçanicë, Kllokot dhe në Shtërpcë. Ata kanë zhvilluar një strukturë të fuqishme partiake dhe kanë shfrytëzuar pjesëmarrjen në qeverinë e Kosovës për të zgjeruar ndikimin e tyre. Rada Trajkoviq dhe Rangjell Nojkiq gjithashtu kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mobilizimin e serbëve të Graçanicës. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ka luajtur rol vendimtar në mobilizimin e serbëve të Ranillugut për dalje në zgjedhje.

#### a) Dalja në zgjedhje, faktet dhe shifrat

Zgjedhjet komunale të 15 nëntorit janë mbajtur për të zgjedhur kryetarët e ri të komunave dhe kuvendet e reja komunale. Në komunat ku kandidatët për kryetarë të komunave nuk kanë marrë vota të mjaftueshme, më 13 dhjetor është mbajtur balotazhi.

<sup>27</sup> KIPRED, intervistë me një politikan serb të Kosovës, 17 dhjetor 2009.

<sup>28</sup> Vëzhguesit e KIPRED-it në Graçanicë dhe në Ranillug, 15 nëntor 2009.

<sup>29</sup> Partitë e serbëve të Kosovës janë certifikuar në komunat vijuese: Gjilan, Istog, Kamenicë, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Shtërpce, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

<sup>30</sup> Ky numër i përafërt është nxjerrë nga KIPRED-i nga lista e votuesve e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nga vlerësimet për numrin e popullatës në komunat e Kosovës.

Partitë e serbëve të Kosovës në raundin e parë fituan postet e kryetarëve të komunave në tri komuna – Graçanicë, Kllokot dhe në Ranillug, ndërsa zgjedhjet e balotazhit vendosen kryetarët e komunave për Novobërdë dhe Shtërpçë, ku serbë përbëjnë përafërsisht 75% të popullatës së përgjithshme.

Në Graçanicë nga 16,317 votues, vlerësohen të jenë 14,000 serbë të Kosovës. Nga ky numër, 3,854 (24%) dolën në zgjedhje, nga të cilët 3,723 serbë dhe 131 shqiptarë. SLS-ja ka marrë 2,216 (61%) për kryetarin e komunës dhe 2,139 (60%) për kuvendin komunal. Vidovdani ka marrë 423 vota (12%), Lëvizja Serbe e Rezistencës (SPOT) 393 (11%), Partia Demokratike Serbe për Kosovë e metohi (SDSKiM) 208 (6%), Partia Serbe e Kosovës e metohisë (SKMS) 135 (4%).

Në Kllokot nga 2,706 votues, dolën në zgjedhje 687 (25,4%). Vetëm dy parti kanë garuar atje, SLS-ja dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). SLS-ja ka fituar 510 (100%) vota për kryetarin e komunës dhe 401 vota (65%) për kuvendin komunal.

Në Ranillug, nga 4,822 votues, në zgjedhje dolën 670 (14%), ku lista e pavarur e qytetarëve Lista për Ranillugun më të Mirë (GIZOR), e udhëhequr nga kryetari lokal i SPO-së ka fituar si garën për kryetar komune me 421 vota (71%), ashtu edhe atë për kuvend komunal me 411 vota (73%). SKMS-ja morri 153 vota (27%).

Në Novobërdë nga 7,939 votues, në zgjedhje dolën 2,035 (26%). Numri i serbëve të Kosovës që morën pjesë në zgjedhje ka qenë 585, ndërsa ai i shqiptarëve 1,450. Serbët kanë humbur shumicën si në kuvendin komunal, ashtu edhe në garën për kryetar të komunës, edhe pse ata përbëjnë 75% të popullatës së gjithëmbarshme në komunë. Iniciativa Qytetare për një të Ardhme më të Mirë (GIZBB), e udhëhequr nga Partia Socialiste e Serbisë (SPS) ka marrë 237 vota (13%), Unioni i Socialdemokratëve të Pavarur (SNSD) - 212 vota (11%) dhe SLS - 103 vota (6%). Partitë e shqiptarëve kanë marrë si në vijim – LDK 619 vota (30%), Aleanca për Kosovën e Re (AKR) - 316 vota (16%), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) - 223 vota (11%) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) - 132 vota (6%). Nga 15 këshilltarë të kuvendit komunal, partitë serbe kanë 5 këshilltarë komunalë, ndërsa ato shqiptare 10 sish.

Në balotazhin për kryetarë të komunës, të mbajtur më 13 dhjetor, në Novobërdë në zgjedhje kanë dalë 2541 votues (33%), nga të cilët kandidati i LDK-së për kryetar komune mori 2,032 vota (81%), ndërsa kandidati serb nga SNSD mori 479 vota (19%). Është shumë me rëndësi të ceket se shumë serbë kanë votuar për kandidatin e LDK-së, kryetarin aktual të komunës.<sup>31</sup> Serbët thonë se kryetari i komunës ka bërë shumë për ta, dhe ka ndihmuar drejtpërsëdrejti kthimin e personave të zhvendosur në Klokubar, ka ndërmarrë projekte infrastrukturore, dhe çka është më e rëndësishmja, i ka vizituar ata pas çdo incidenti<sup>32</sup>. Madje edhe OJQ-të e afërta me Kishën ortodokse serbe deklarojnë se LDK-ja ka bërë më shumë për ta sesa komuna paralele. Nga ana tjetër, SNSD ka akuzuar LDK-në për vjedhje masive të votave, dhe në një moment gjatë 13 dhjetorit kanë thirrur ICO-në për ta pyetur nëse edhe ata mund t'i vjedhin votat gjithashtu.<sup>33</sup>

Në Shtërpçë nga 12,260 votues, përafërsisht janë 8,700 serbë dhe 3,500 shqiptarë. Numri i atyre që dolën në votime në raundin e parë ishte 3,789 (31%), nga të cilët 1,626 serbë

<sup>31</sup> Vëzhguesit e KIPRED-it në Novobërdë, 13 dhjetor 2009. Intervistat e KIPRED-it me votuesit serbë, me pjesëtarët e partive politike dhe me priftërinjtë lokalë të Kishës ortodokse serbe.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> KIPRED, intervista me zyrtarët e ICO-së dhe SNSD-së, 14, 15 dhjetor 2009.

dhe 2,163 shqiptarë. SLS-ja mori 1,330 vota (40%) për kryetarin e komunës dhe 1,258 (40%) vota për kuvendin komunal. Lista qytetare së bashku me Zhupën e Sirinicës (ZZSZ), të udhëhequra nga SPO-ja lokale mori 157 vota (5%). Pesë listat e tjera serbe kanë marrë 4% të votave dhe nuk do të jenë të përfaqësuara në kuvendin komunal. Partitë e shqiptarëve të Kosovës morën votat si në vijim: PDK 775 (25%), PSK 386 (12%) dhe LDK 375 (12%). Nga 19 këshilltarë të kuvendit komunal, partitë shqiptare të Kosovës fituan 10 këshilltarë, ndërsa 9 sish u përkasin dy partive të serbëve të Kosovës.

Në zgjedhjet e balotazhit për kryetar të komunës më datën 13 dhjetor në Shtërpçë dolën në zgjedhje 6,343 votues (54,3%), nga të cilët 4,345 serbë dhe 2,344 shqiptarë. Kandidati i SLS-së fitoi 65%. Dalja e serbëve ka qenë më e madhe sesa në cilatdo zgjedhje të mëparshme, dhe shumë më e madhe sesa në zgjedhjet paralele të organizuara nga Serbia në vitin 2008, ku përafërsisht 3,500 serbë votuan në Shtërpçë<sup>34</sup>. Kjo dalje e madhe e serbëve në zgjedhje ishte befasia më e madhe, dhe të punësuarit e strukturave paralele gjithashtu morën pjesë në to – gjegjësisht ata që janë të punësuar në sektorin shëndetësor dhe në atë të arsimit, ku disa prej tyre haptazi kanë ftuar për pjesëmarrje në zgjedhje.<sup>35</sup> Dukej se ekzistonte një konsensus i heshtur në mesin e serbëve në Shtërpçë që të përkrahin SLS-në, duke marrë parasysh privatizimin që pritet të ndodhë së shpejti të qendrës së skijimit dhe të objekteve përcjellëse të saj. Gjithashtu edhe serbët janë të vetëdijshëm për rëndësinë e komunës së re dhe për përparësitë që do t'u jepen atyre.

#### IV. Përfundim

Dalja e kënaqshme e serbëve në zgjedhje, përmes të cilave u legjitimizuan komunat e reja, është një hap i madh, i cili ndërron nga themeli marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Pjesëmarrja e serbëve ishte dhjetë herë më e lartë sesa në zgjedhjet e nëntorit 2007. Për herë të parë pas dy dekadave, serbët e Kosovës janë kthyer drejt forcave të moderuara politike, duke dërguar kështu sinjal për bashkëpunim dhe përfshirje brenda kornizës institucionale të Kosovës.

Përfundimi i suksesshëm i procesit zgjedhor – të parit në Kosovën e pavarur, paraqet bazën për ndërtimin e një shteti shumetnik dhe të një shoqërie shumëkulturore. Po kështu, serbët i kanë dërguar Beogradit, Prishtinës dhe bashkësisë ndërkombëtare porosi të qartë kundër ndarjes së Kosovës. Kjo duhet të jetë porosi e qartë, e cila duhet të pasohet nga donatorët dhe qeveria e Kosovës përmes projekteve strategjike të shpejta dhe konkrete të investimeve në komunat e reja dhe në vendbanimet e tjera serbe.

Përveç Kosovës së veriut, në pjesët e tjera në jug të Iberit, marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve do të trajtohen përmes institucioneve legjitime dhe duke respektuar rrugët ligjore. Kjo do të shënojë një dimension të ri në zhvillimin e shoqërisë së Kosovës. Integriteti territorial gjithashtu do të varet nga ky proces.

Sfida kryesore që gjendet përpara ka të bëjë me organizimin e një numri zgjedhjesh komunale në veriun e Kosovës, kryesisht për Mitrovicën e veriut në maj të vitit 2010. Bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin Ligjit (EULEX) dhe ICO, së bashku me qeverinë e Kosovës, duhet të krijojnë një klimë të sigurisë dhe të perspektivës ekonomike për serbët e veriut. Serbët do të ngacmohen dhe

---

<sup>34</sup> Duke i përfshirë edhe personat e zhvendosur në Serbi, Komisioni republikan i zgjedhjeve i Serbisë (REC) dha numrin gjithsej prej 4,787 votave në Shtërpçë. Megjithatë, REC-ja nuk dha shifrat e ndara, dhe numri që KIPREDI e përdorë vjen nga informata dhe intervistat në terren, të marra në Shtërpçë.

<sup>35</sup> Vëzhguesit e KIPRED-it në Shtërpçë, 13 dhjetor 2009.

kërcënohen fizikisht për sa kohë që strukturat paralele të zbulimit dhe të sigurisë vazhdojnë të funksionojnë lirshëm në atë rajon. Me një klimë të tillë, çfarëdo tentimesh për organizmin e zgjedhjeve në veri do të jenë të pasuksesshme.